



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019) dhe nenit 40 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, Duke vepruar sipas lëndës së formuar pas denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK) në seancën e 80-të të mbajtur më 18.01.2023 ka miratuar sa vijon

VENDIM

procedura sipas lëndës me numër 12-1236/1, datë 24.02.2022, e formuar sipas denoncimit nga një parashtrues i njohur me pretendime për korrupsion ndaj një kontrollori në _____, NDËRPRITET .

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave , nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për arsye se ka vepruar dhe ndërmarrë masa organi tjetër kompetent.

Lënda me numër 12-1236/1 të datës 24.02.2022 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Më datë 24.02.2022, një parashtrues i njohur ka bërë denoncim me pretendime për korrupsion ndaj një kontrollori në _____ dhe është konstatuar lënda me numër 12-1236/1, datë 24.02.2022.

Në denoncim parashtruesi thekson se ngjarja ka ndodhur më datë 30.11.2021 rreth orës 10 në autobusin e _____, kur në autobus hipnin dy persona fizikë, njëri prej të cilëve ka mundur të paguajë me telefon dhe tjetri ka dështuar edhe pas pesë përpjekjeve. Kjo është vërejtur nga një kontrollor, të cilit i janë treguar telefonatat nga tentativat për pagesë, por ai është sjellë në mënyrë fyese ndaj pasagjerit, gjatë së cilës i ka kërkuar një kartë identiteti, të cilën pasi ia kanë dhënë, nuk ka dashur ta kthejë deri sa nuk zbret udhëtari. Në vijim thuhet se kur kanë zbritur nga autobusi, kontrollori ka kërkuar 500 denarë për të mos shkruar shënim dhe pasi personat kanë deklaruar se nuk kanë, ka kërkuar dhe ka marrë 200 denarë nga parashtruesi i denoncimit. Parashtruesi thekson se rastin e ka paraqitur në kontrollin e brendshëm në _____, por nga ana e tyre nuk është marrë asnjë masë.

Me qëllim të verifikimit të pretendimeve dhe përcaktimit të gjendjes faktike në rastin e denoncuar, KSHPK-ja ka dorëzuar kërkesë për mbledhjen e informatave nga _____.

Në afatin e përcaktuar ligjërisht është marrë informacioni i kërkuar dhe nga mbikëqyrja e dokumentacionit të marrë është konstatuar kjo gjendje faktike:

- Pas dhënies së provave, udhëheqësi i departamentit të kontrollit të biletave në _____ paraqiti propozimin për fillimin e procedimit disiplinor për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore për një kundërvajtje disiplinore nga data 29.12.2021.
- Nga drejtori i _____ me vendim të datës 03.01.2022 është ngritur komisioni për zhvillimin e procedimit disiplinor për shkeljet disiplinore, i cili në përputhje me kompetencat e përcaktuara ligjore ka kryer procedimin disiplinor dhe ka paraqitur propozim - masë të datës 11.01.2022 drejtorit të ndërmarrjes.
- Drejtori i ndërmarrjes, duke vepruar në lidhje me këtë çështje, ka kontrolluar të gjithë dokumentacionin, ka konstatuar gjendjen faktike dhe duke marrë parasysh rrethanat rënduese në të cilat është kryer vepra, ka pranuar plotësisht masën e propozuar të komisionit për zhvillimin e procedimit disiplinor me të cilin ka marrë vendim për shqiptimin e masës disiplinore për kundërvajtje disiplinore të datës 12.01.2022. Me vendim i është shqiptuar masë disiplinore të denoncuarit – gjobë në masën 30% të shumës së pagës neto të paguar në muajin e fundit para shkeljes disiplinore, në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj.

Nga të gjitha konstatimet e lartpërmendura, KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprime të mëtutjeshme lidhur me rastin sepse organi kompetent ka vepruar dhe ka marrë masa për rastin në fjalë, prandaj edhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar deri:

Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: B.K.SH

Miratoi: SPD, Anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHTETËRORE
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT

Nënkryetar

Mr. Vlladimir Georgiev